



Vlerësimi i leximit në klasat e hershme - A-EGRA

Qëllimi i programit:

Fakulteti i Edukimit në kuadër të Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA), do të ofrojë programin e zhvillimit profesional për ngritjen e kapaciteteve tek mësuesit në përdorimin e instrumentit EGRA për vlerësimin e leximit në klasat e hershme. Nevoja për identifikimin e hershëm të veshtirësive në lexim dhe intervenimin e hershëm përmes punës cilësore të mësuesit është domosdoshmëri. Prandaj përmes programit A-EGRA mësuesit do të kenë mundësi që përmes qasjes së individualizuar të sigurojnë rezultatet të efektshme edhe për nxënësit në nevojë.

Grupi i synuar i mësuesve /vijuesve:

Ky program i dedikohet mësuesve të nivelit fillor, me qëllim që të zgjerojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre për tu ardhur në ndihmë fëmijëve gjatë përvetësimit të shkathtësive të lexim-shkrimit.

Rezultatet e programit:

Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që deri në përfundimit të trajnimit të:

- Administrojnë testin EGRA
- Identifikojnë nxënësit që kanë nevojë për përmirësimin e shkathtësive të leximit
- Dallojnë nevojat specifike të leximit
- Zbatojnë strategji për përmirësimin e leximit
- Hartojnë plane mësimore duke integruar strategji për përmirësimin e leximit.
- Vlerësojnë nevojën për zbatimin e testit EGRA